Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*
Gjemajli Bellanica	21.04.2022	29.04.2022	*75/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 25.03.2022 OE "Vlera" sh.p.k Shtime**,** ka parashtruar ankesë me nr.75/22 kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetit të prokurimit me titull: "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi(DDD) i objekteve të Spitalit", me nr. të prokurimit: **70010-22-851-2-2-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Spitali Regjional Prizren**.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar kontratë publike kornizë me një operator ekonomik, procedurë të hapur, Shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 53 877,12 €

Data e njoftimit për kontratë.....21.02.2022.
Formulari standard për korrigjim e gabimeve.....25.02.2022.
Hapja e ofertave.....18.03.2022.
Data e kërkesës për rishqyrtim.....13.03.2022.
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesës për rishqyrtim.....16.03.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE TË: OE “Vlera” sh.p.k Shtime

Dispozitat e shkelura

Neni 1 - Qëllimi
Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 64 - Dëshmitë e kërkesave
Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Pika 1 :
Ak nuk ka respektuar afatin kohore 10 ditore pas shqyrtimit te ankeses tone duke vazhduar menjeher me procedure te prokurimit .

Perpos kesaj pergjigjet qe i kemi marrur nga AK kane qene mjafte te mangta duke mos marrur asnje pergjigje se ku jane bazuar per perpilimin e specifikacionit te tyre.

Pika 2 :: Kerkesa nga Ak per “ ***Një punëtor i diplomuar në shëndet puiblik./ Të sillet diploma master profesional në shëndet publik.***
Ne si Operator Ekonomik e vleresojm si diskriminuese kerkesen e AK per te kerkuar diploma pasuniversitare(Maxhistrature) per punetorin.
Ne në parim jemi pajtuar qe punetori te kete diplome Universitare (baxhelor) te Shendetit Publik por jo edhe diploma pasuniversitare.
Ne besojm qe diplomat pas Universiatare si Maxhistatura dhe Doktoratura nuk kerkohen ne Procedura te Prokurimit ne asnje nivel (kur behet fjale per punetorin teknik jo udheheqesin e tyre)sepse kjo nuk eshte procedure rekrutimi per Universitete por per sherbime DDD .
Ne gjithashtu jemi pajtuar qe te kete Epidemiologu (mjek me specializim) i cili udheheq punetoret teknik por ne asnje Standard ne Kosove , apo Europian ,apo nderkombetar,referimi tjeter teknik te nxjerre nga organet evropiane per standartizim etj nuk e parasheh qe punetori te kete diploma maxhistrature apo doktorature.
Kete AK nuk e ka demantuar ne kthimin e pergjegjes se ankimit tone se ne cilin Standard jane bazuar per kete specifik teknike.
AK ketu perpos shkeljes se dispozitave ligjore te NENIT 69 ka bere edhe shkelje te NENIT 28 pika 2 dhe 7 (LPPK)ku thote :

2. Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.
7. Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fialët "ose ekuivalent"

Pika 3 : KERKESA E AK : Një punëtor i diplomuar në menagjimin e emergjencave – 3 vite përvojë pune.

Edhe kete kerkese e shohim si diskriminuese ,sidomos per sherbimet qe AK eshte duke kontraktuar .
DDD nuk ka fare te beje me menagjim te emergjencave sepse procedurat-trajtimet gjithmon kryhet njesoj (me doreza ,maska,kostume speciale mbrojtese) te cilat i parasheh standartizimi Europian ISO dhe HACCAP, prandaj kjo kerkese njesoj si kerkesa me larte shkel dispozitat e nenit 28, pika 2 dhe 7.
Edhe per kete pike AK ne pergjigjen e marre nuk na ka argumentuar se ne qfare STANDARDE specifikisht jane bazuar .

Pika 4 : KERKESA E AK /DËSHMIA 8. Lista e preparateve me të dhënat (Emri i prodhuesit, përbërja, Numri CAS, Numri Ec, frazat e rrezikut, mënyra e përdorimit) dëshmi Etiketat e produktit, A-testet e preparateve, Certifikata e Analizës, Dokumentacioni i të dhënave të sigurisë me të gjitha fletat përcjellëse, të gjitha të jenë përkthyera në gjuhën shqipe.

Ne kete pike ne kemi kerkuar qe disa nga te dhenat te jene ne gjuhen Angelze sepse jane me mijra faqe dokumentacione per produktet dhe do te ishte kosto shume e madhe per kompanin qe te perkthehen ne gjuhen Shqipe,

Perkthimi i A-testeve duhet te behet nga perkthyes te autorizuar nga kompania qe prodhon produktet , gjë qe eshte e pamundur per secilin OE.
Kete pike AK e ka refuzuar .
Ne si OE e dijm qe tenderet per Prokurim publik jane te hapura edhe per kompanit nga Europa Amerika e tjere, dhe nuk mundesh ti detyrosh me asnje ligje qe preparatet te perkthehen ne gjuhen e Autoritet Kontraktues.
Gjithashtu Gjuha Angleze eshte gjuhe zyrtare ne Kosove dhe me ligjet administrative ne Kosove mund te dorezohen dokumentacione edhe ne kete gjuhe.

Dyshimet tona jane te medha se pse AK nuk e ka shtyer aktivitetin pas shqyrtimit te ankeses sone , dhe pse eshte vetem nje Ofertues me cmim maksimal , (ashtu siq e ka cekur ne ankese para ofertimit).

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

KËRKESA 1. Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik

KËRKESA 2. Regjistrimi i TVSH.

KËRKESA 3. Regjistrimi i Numrit Fiskal.

KËRKESA 4.Licenca e lëshuar nga institucionet relevante për përdorimin e preparateve dhe kryerjen e shërbimeve për DDD brenda territorit të Republikës së Kosovës.

KËRKESA 5. Leja e Importit për produkte biocide insekticide të lëshuar nga autoritet relevante të Republikës së Kosovës.

KËRKESA 6. Të jetë i certifikuar me standardin ISO 9001 2015 për cilësinë e shërbimeve të DDD nga një kompani e akredituar.

KËRKESA 7. Të jetë i certifikuar me standardin ISO 14001 2015 për mbrojtjen e ambientit nga preparatet e DDD nga një kompani e akredituar

KËRKESA 8. Të jetë i certifikuar me standardin OHSAS 45001- 2018 për mbrojtje ne pune e preparate dhe substanca te ndryshme nga një kompani e akredituar.

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

KËRKESA 1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme AK-së për qarkullimin vjetor. OE gjatë tri viteve të fundit (prej momentit të publikimit të njoftimit për kontratë) në vlerë prej 105,000.00€.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

KËRKESA 1.Operatori Ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar kontrata me sukses gjatë tri viteve të fundit nga publikimi i njoftimit për kontratë, për shërbime të njëjta në vlerë prej 80,000.00€.

KËRKESA 2.Kërkohet një Epidemiolog të diplomuar me licencë pune dhe kontratë valide paku 5 vite përvojë pune.

KËRKESA 3. a)Inxhinier teknik sanitar me kontratë valide së paku 3 vite përvojë pune, b)Ekolog me kontratë valide së paku 2 vite përvojë pune.

KËRKESA 4. 6 Punëtor për përdorim të produkteve biocide dhe pajisjeve (në lëmine e DDD-së)

KËRKESA 5. Një punëtor i diplomuar në shëndet publik

KËRKESA 6.Një punëtor i diplomuar në menagjimin e emergjencave – 3 vite përvojë pune.

KËRKESA 7.OE duhet të dëshmon se posedon mjete, stabilimentet ose paijsjet teknike që ka në dispozicionin për realizimin e shërbimeve të DDD-së. Pajisjet minimale për këtë projekt kërkohen; a) së paku 5 pompa ULV elektrike, b) 5 pompa motorike LV, c) 1 ULV aersol të vendosur në automjet për dezinsektim në hapësira të jashtëm, d) së paku 3 automjete për kryerjen e shërbimeve, e) 20 copë syza mbrojtëse, f) 50 copë rroba një përdorimshe.

KËRKESA 8. Lista e preparateve e nënshkruar dhe vulosur në origjinal nga OE.

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

DËSHMIA 1.Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit së bashku me përshkrimin e veprimtarive primare dhe sekondare të kompanisë).

DËSHMIA 2.Kopja e Certifikatës për Regjistrimin në TVSH.

DËSHMIA 3. Kopja e Certifikatës të numrit fiskal.

DËSHMIA 4. Leja valide nga MPBZHR

DËSHMIA 5. Leja për biocid insekticid të lëshuar nga autoritetet relevante

DOKAZ 6. Važec´i standard ISO 9001 2015, takođe mora imati link za onlajn verifikaciju.
DËSHMIA 7. Standardi ISO 14001 2015 valide, duhet të ketë edhe linkun e verifikimit online.
DËSHMIA 8.Standardi OHSAS 45001 2018 valide, duhet të ketë edhe linkun e verifikimit online.

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

DËSHMIA 1.OE duhet të dëshmoj me qarkullime nga ATK-ja për tri vitet e fundit se ka qarkullim prej 105,000€ (prej momentit të publikimit të njoftimit për kontratë).

Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

DËSHMIA 1. Lista e projekteve të realizuara të dëshmuar me kopjet e referencave apo çertifikatave të pranimeve në 3 vitet e fundit, minimumi 80,000€ të natyrës së DDD-së si dhe minimumi të paraqes një referenc për luftimin e Covid-19 në objekte me pacient të infektuar, duke saktësuar punët e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin

DËSHMIA 2.Të sjellet diploma Universitare e noterizuar, licencë pune dhe kontratë valide së bashku me CV.

DËSHMIA 3. a,b)Diploma ose certifikatat e noterizuara, përvoja e punës dëshmi CV-ja.

DËSHMIA 4. Kontratat e punës, referencat dhe CV-ja minimumi 3 vite përvojë pune në lëminë e DDD-së

DËSHMIA 5.Të sillet diploma master profesional në shëndet publik, kontrata e punës, CV-ja minimumi 2 vite përvojë pune në lëminë e DDD-së.

DËSHMIA 6. Diploma Universitare e noterizuar.

DËSHMIA 7.Lista e paisjeve origjinale e nënshkruar dhe vulosur nga OE, të dëshmohet pronësia me faturë të blerjes, DUD doganor ose kontrate të marrjes me qera për periudhën 3 vjeqare. Për automjete të kërkohet dëshmi librezat valide. Për të gjitha paisjet OE duhet të prezantoj garancionet e tyre që janë funksionale nga prodhuesi.

DËSHMIA 8. Lista e preparateve me të dhënat (Emri i prodhuesit, përbërja, Numri CAS, Numri Ec, frazat e rrezikut, mënyra e përdorimit) dëshmi Etiketat e produktit, A-testet e preparateve, Certifikata e Analizës, Dokumentacioni i të dhënave të sigurisë me të gjitha fletat përcjellëse, të gjitha të jenë përkthyera në gjuhën shqipe.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Nuk ka raport të bashkangjitur në E prokurim

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE "Vlera" sh.p.k Shtime

Përgjigje në Pretendimin ankimor 1

OE ankues pretendon se AK-ja nuk ka respektuar afatin kohor 10 ditor pas shqyrtimit të ankesës tonë duke vazhduar menjëherë me procedurën e prokurimit.

Lidhur me këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues sqaron se në përgjigjen për rishqyrtim të dt. 16.03.2022, AK-ja i ka dhënë këshillë juridike palës së pa kënaqur me vendimin e AK-së, që konform Nenit 109 të LPP-së mund të paraqes ankesë në OSHP brenda dhjetë ditëve nga dita e pranimit të vendimit, mirëpo me dt. 18.03.2022 AK-ja ka bërë hapjen e ofertave duke mos respektuar afatin ligjor për parashtrim të ankesave në OSHP. Andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar për faktin se AK-ja nuk është dashur të vazhdoj me hapjen e ofertave.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 2

OE ankues lidhur me kërkesën e AK-së "Një punëtor i diplomuar në shëndetin publik", " Të sillet diploma master profesional në shëndet publik. Ne si OE e vlerësojmë si diskriminuese kërkesën e AK-së për të kërkuar diploma pasuniversitare (Magjistrature) për punëtorin. Ne në parim jemi pajtuar që punëtori të ketë diplomë Universitare (bachelor) të shëndetit publik por jo edhe diplomë pasuniversitare. Ne besojmë se diplomat pas universitare magjistraturë dhe doktoratë nuk kërkohen për procedura të prokurimit në asnjë nivel (ku bëhet fjalë për punëtorin teknik jo udhëheqësin e tyre) sepse kjo nuk është procedurë rekrutimi për universitete por për shërbime DDD. Ne gjithashtu jemi pajtuar të ketë Epidemiolog (mjek me specializim) i cili udhëheq punëtorët teknik të nxjerrë nga organet evropiane për standardizim etj nuk parasheh që punëtori të ketë diploma magjistrature apo doktoratë.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e njoftimit për kontratë dhe formularit standard për korrigjimin e gabimeve është: "Një punëtor i diplomuar në shëndet publik" Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "Të sillet diploma master profesional në shëndet publik, kontrata e punës, CV-ja minimumi 2 vite përvojë pune në lëmine e DDD-së".

Për këtë pretendim ankimor, eksperti shqyrtues mendon që kërkesa për një punëtorë në shëndetin publik është në rregull, ndërsa dëshmia që të sillet diploma master profesional në shëndetin publik është e tepërt dhe një kërkesë e tillë është dashur të hiqet. P.SH dëshmia për diplomë të kërkohet vetëm diplomë në shëndetin publik, kontrata e punës, CV – ja, minimumi 2 vite përvojë pune në lëmine e DDD-së.

Gjithashtu AK-ja në përgjigjen e kërkesës për rishqyrtim nuk ka arsyetuar, argumentuar se pse ka kërkuar diplomë master profesional.

Ndërsa kërkesa për Epidemiolog nga ana e AK-së është kërkesë në harmoni me aktivitetin e prokurimit.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 3

OE ankues thekson se edhe kërkesa e AK-së " Një punëtorë i diplomuar në menaxhimin e emergjencave – 3 vite përvojë pune. Edhe këtë kërkesë e shohim si diskriminuese , sidomos për shërbimet që AK është duke kontraktuar.

DDD nuk ka fare të bëjë me menaxhim të emergjencave sepse procedurat-trajtimet gjithmonë kryhet njësoj (me doreza, maska, kostume speciale mbrojtëse) të cilat i parasheh standardizimi Europian ISO dhe HACCAP, prandaj kjo kërkesë njësoj si kërkesat më lartë shkel dispozitat e nenit 28, pika2 dhe 7. Edhe për këtë pikë AK-ja në përgjigjen e marrë nuk na ka argumentuar se në çfarë standarde specifikisht janë bazuar.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e njoftimit për kontratë dhe formularit standard për korrigjimin e gabimeve është: "*Një punëtor i diplomuar në menaxhimin e emergjencave – 3 vite përvojë pune*"

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: " *Diploma Universitare e noterizuar* ".

Për këtë pretendim ankimor eksperti shqyrtues mendon që kjo kërkesë e AK-së është dashur të largohet për shkak se AK-ja ka kërkuar standardin ISO 14001 2015 dhe OHSAS 45001 2018 dhe janë të mjaftueshme për këtë aktivitet të prokurimit, Andaj eksperti shqyrtues vlerëson që AK-ja gjatë përpilimit të specifikave teknike të ketë në konsideratë qëllimin e aktivitetit, të mos ketë diskriminim, ta hap më shumë konkurrencën dhe hartimin e specifikimeve teknike ta bëjë konform dispozitave ligjore të LPP-së.

Përgjigje në Pretendimin ankimor 4

OE ankues thotë se "Lista e preparateve me të dhëna (emri i prodhuesit, përbërja, Numri CAS, Numri Ec, frazat e rrezikut, mënyra e përdorimit) dëshmi Etiketa e produktit, A-testet e preparateve, Certifikata e Analizës, Dokumentacioni i të dhënave të sigurisë me të gjitha fletat përcjellëse, të gjitha të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe.

Në këtë pikë ne kemi kërkuar që disa nga të dhënat të jenë në gjuhën Angleze sepse janë me mijëra faqe dokumentacione për produktet dhe do të ishte kosto shumë e madhe për kompaninë që të përkthehen në gjuhën shqipe. Përkthimi i A-testeve duhet të bëhet nga përkthyes të autorizuar nga kompania që prodhon produktet, gjë që është e pa mundur për secilin OE.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e njoftimit për kontratë dhe formularit standard për korrigjimin e gabimeve është: "*Lista e preparateve e nënshkruar dhe vulosur në origjinal nga OE*"

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Lista e preparateve me të dhënat (Emri i prodhuesit, përbërja, Numri CAS, Numri Ec, frazat e rrezikut, mënyra e përdorimit) dëshmi Etiketat e produktit, A-testet e preparateve, Certifikata e Analizës, Dokumentacioni i të dhënave të sigurisë me të gjitha fletat përcjellëse, të gjitha të jenë përkthyera në gjuhën shqipe*".

Gjithashtu edhe kërkesa e AK-së që të gjitha dëshmitë e kërkesës të jenë të përkthyera në gjuhën shqipe mendoj se është e tepërt dhe AK-ja ka mundur të kërkoj të jetë në njërën nga gjuhët zyrtare. Andaj AK-ja me kërkesat e dosjes së tenderit do të duhej ta hapte konkurrencën dhe t'i jepe më shumë hapësire operatorëve tjerë që të ofertojnë në mënyrë që të arrijë vlerën për para si dhe kërkesat t'i bëjë në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së.

Duke marre parasysh shqyrtimin e shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, Eksperti shqyrtues e sheh ankesat e operatorit ekonomik ankues si pjesërisht të bazuara, duke sugjeruar që aktiviteti i prokurimit me titull "**Dezinfektimi,Dezinsektimi dhe Deratizimi (DDD)**" të anulohet. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i shtjellimeve të pretendimeve ankimore dhe duke u mbështetur në nenin 44.5 pika (ix) të RROUP ku thuhet: "*një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi*". Për faktin se AK-ja ka hapur ofertat pa kaluar afati ligjor prej 10 ditëve për dërgim të lëndës në OSHP, të cilin AK-ja ia ka dhënë si këshillë juridike operatorit ekonomik ankues në përgjigjen e dhënë në kërkesën për rishqyrtim. Nëse më teje AK ka interes mund ta inicioj përsëri aktivitetin e prokurimit.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "Vlera" sh.p.k Shtime të aprovohet si pjesërisht e bazuara, dhe aktiviteti i prokurimit të anulohet .

Raporti i ekspertizës t'i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - Spitali Regjional Prizren
Panelit Shqyrtues - OSHP
OE ankues - OE "Vlera" sh.p.k Shtime